

KONTRATË

Numri i kontratës ¹: 613-26-3165-1-2-1/C1209



Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani** në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues; dhe

KATRORI GROUP SH.P.K., Rr. Lidhja e Prizrenit Hy 197 Nr 32, Prishtinë, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:






Llot 1 Furnizimi i çerdheve me materiale të imëta-shtrojë e mbulojë dhe enë për kuzhinë. me numër identifikues: 613-26-3165-1-2-1





Neni 1 Lënda



1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:






Nr.	EMRI I ARTIKULLIT	FOTO IMAZH	PËRMBAJTJA E ARTIKULLIT
1	Jorgan gjumi për fëmijë mosha 1-3 vjeç (dim. 100x80cm)		Përmasa: 100x80 cm (Gjerësia & gjatësia); Materiali: I mbushur me fibra100% Pambuk organik, mbushje netyrale; I Ajrosshëm, i ngrohtë, dhe i këndshëm për prekje;Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik); Lahet në makinë në 40°C; Ngjyra: Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyres (Preferohen një ngjyrëshe i bardhë dhe me figura për fëmijë si në figurë)
2	Mbulesë për jorgan (Kellef jorgani me dim. 110x90 cm)		Përmasa: 110x90cm (Gjerësia & gjatësia); Materiali: I mbushur me fibra100% Pambuk organik, mbushje netyrale; I Ajrosshëm, i ngrohtë, dhe i këndshëm për prekje;Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik); Lahet në makinë në 60°C; Ngjyra: Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyres (Preferohen një ngjyrëshe rozë dhe e kaltër si dhe ilustruar me figura për fëmijë si në figurë)




¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.






3	Mbulesë për jorgan (Kellef jorgani me dim. 110x130 cm)		Përmasa: 110x130 cm (Gjerësia & gjatësia); Materiali: I mbushur me fibra100% Pambuk organik, mbushje netyrale; I Ajrosshëm, i ngrohtë, dhe e butë për prekje;Mikrofibra hipoalergjik (Anti alergjik); Lahet ne makinë në 60°C Ngjyra: Ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres (Preferohen një ngjyrëshe rozë dhe kaltër si dhe ilustruar me figura për fëmijë si në figurë); Mbyllje me zingjir
4	Mbështjellës për dyshek pjesa e fundit me llastik për fëmijë mosha 1-5 vjeç (dim. 70x140 cm)	 	Përmasa: Mbështjellës për dyshek pjesa e fundit me llastik për fëmijë mosha 1-5vjeç (dim. 70x140 cm) ; Materiali: 100% pambuk Stabilizon temperaturën trupore Anti-alergjik Fundin me llastik për qëndrim në dyshek gjatë fjetjes Lahet ne makinë larëse në 40°C; Ngjyra: Preferohen me mbështjellës me dizajnin përplot ngjyra dhe figura te dashura per femijë te vegjel 1-3vjeç dhe femijë te moshes 1-6vjeç. Perzgjrdhja e figurave behet se bashku me drejtoreshen.
5	Jastëk gjumi (per femije dim.50x40 cm)		Përmasa: Jastëk (dim.50x 40 cm); Materiali: 100% pambuk me mikrofibra natyrale, Stabilizon temperaturën trupore, Lartësi dhe fortësi e rregullueshme, Anti-alergjik, Ideal për çdo pozicion fjetje, Lahet në makinë larëse në 40°C; Ngjyra: Preferohen me mbështjellës përplot ngjyra dhe figura të dashura për fëmijë
6	Peshqirë për duar (dim. 45 x75 cm)		Përmasa: Peshqir për duar (dim. 45 x75 cm); Materiali: Pambuk organik 100% , Të absorbojnë ujin mirë dhe shpejt. Të ketë po ashtu një dorezë shumë praktike, në qoshe të peshqirit. Shumë i butë në fërkim. Lahet në makinë larëse në 90°C; Ngjyra : Preferohen ngjyra e bardhë ose ngjyra të hapura.
7	Peshqirë për duar (dim. 50 x100 cm)		Përmasa: Peshqir për duar (dim. 50 x100 cm); Materiali: Pambuk organik 100% , Të absorbojnë ujin mirë dhe shpejt. Të ketë po ashtu një dorezë shumë praktike, në qoshe të peshqirit. Shumë i butë në fërkim. Lahet në makinë larëse në 90°C; Ngjyra : Preferohen ngjyra e bardhë ose ngjyra të hapura.



8	Peceta për enë (dim.45x65cm)		Përmasa: Peceta për enë (dim.45x65 cm); Materiali: Pambuk 100 % , me fibra që absorbojnë ujin mirë dhe shpejt. Lahet në makinë larëse në 40°C; Ngjyra: Preferohen ngjyra e bardhë ose ngjyra të hapura.
9	Mbulesa tryeze (për tavolina buke të fëmijëve) ; dimensione: 120x120 cm		Përmasa : Mbulesa për tavolina buke të fëmijëve (120x120 cm); Materiali: Mbulesë tavoline 100%lio- pambuk, shumë i butë në fërkim, përthith lagështinë shumë shpejtë.Perfekt për tu tharë pas larjes. Mundësisht material anti njollave. Hekuroset ne një temperature tepër te ulet. Lahet në makinë larëse në 40°C; Ngjyra : E bardhë me dizajn të thurur me bordurë në pjesën anësore.
10	Këllëf për jastëk (dim.50x45 cm)		Përmasa: Këllëf për jastëk (dim.50x45 cm); Materiali: Pambuk 100% ,Të buta, Anti - alergjik, Lahet në makinë larëse në 40°C; Ngjyra : Preferohen me ngjyra dhe ilustrime për fëmijë.
11	Karrige për fëmijë		Karrige plastike për fëmijë të grup moshës 1-3vjeç
12	Tavolina plastike për fëmijë		Tavoline të grup moshës 1-3vjeç Të ngjashme me këtë foto
13	Vluese elektrike uji 2L		Bokall per vlimin e ujit ; me peshe 2L; gjam ose ekuivalent
14	Mbajtëse për palloma		Mbajtëse për palloma/foli
15	Tavoline për hekurosje		E pershtashme për qdo vend të shpise ; permasat e mesme ; ngjyra e lehtë
16	Set filgjana për kafe- të mdhenje		Filgjana për kafe ose qaj ; 150ml ; dimensione te mëdhenje gjam ose porcelan 12 pjesesh (6 filgjana dhe 6 tablla)
17	Termos 1.5L		Termos 1.5L qelik ose ekuivalent



18	Vluese elektrike uji 2L		Bokall per vlimin e ujit ; me peshe 2L; gjam ose ekuivalent
19	Tepsi - set per embelsira		Tepsi per embelsira komplet 1/4 me dimesione dhe forma te ndryshme si ne vijim: forme zemre :24 cm; forme e rrumbullaket 26 cm; forme katrore 28 cm;tepsia per kek 25 cm; I materialit rezistene ndaj zjarrit
20	Varese per rroba me mbajtese		Varese per rroba me mbajtese; lartesi 174 cm .Koka rrotullohet për lehtësinë e aksesit dhe mbështetësja përfshin një mbajtëse të integruar për ombrellë. Baza e rëndë në fund siguron stabilitet për qëndrimin e varës.
21	Tharese rrobash		Dizenjuar ne forme praktike me materiale rezistente eshte perfekte per te vendosur rrobat e ndryshme
22	Tengjere me kapak gjami dhe diameter 16 cm		Tenxhere me kapak të dobishëm transparent; materiali: çeliku inox të qëndrueshëm. Kapaku i xhamit me vrimë ajri ju lejon të monitoroni procesin e gatimit pa qenë e nevojshme të ngritni kapakun. Tava ka një kapacitet prej 1.5 litra dhe ka diametër 16 cm. produkti duhet te jet si ne foto
23	Tengjere set 1/5; 10 pjesesh		Të gjitha tenxheret në këtë set kanë një fund me shtresa SIGMA CLASSIC+. Shtresa e brendshme, prej çeliku inox 18/10, është higjienike, e kujdesshme dhe pa shije. Nën të, ka një bërthamë alumini 4 mm, e cila lejon që temperatura të ruhet për një kohë të gjatë dhe të shpërndahet në mënyrë të barabartë në të gjithë sipërfaqen. Shtresa e tretë - ajo e jashtme, është prej çeliku inox cilësor 18/0 me veti magnetike, falë të cilit këto enë mund të përdoren edhe në pllakë me induksion.Dorezat janë prej çeliku të jashtëzakonshëm inox, kapaku i qelqit.- Kapaciteti – 1.5L / 2.1L / 2.9L / 3.9L - Diametri – 16cm / 18cm / 20cm / 22cm /24 cm - Materiali nga çeliku inox i klasit të parë; produkti duhet te jet si ne foto

24	Tengjere me kapak gjami dhe diameter 25 cm		Tenxhere me kapak të dobishëm transparent; materiali: çeliku inox të qëndrueshëm. Kapaku i xhamit me vrimë ajri ju lejon të monitoroni procesin e gatimit pa qenë e nevojshme të ngritni kapakun. Tava ka një kapacitet prej 5 litra dhe ka diametër 25 cm. produkti duhet te jet si ne foto
25	Tigan 32cm me kapak (forme e rrumbullaket, gjerësia 58 mm; materiali : qelik - inox		Një shtresë e veçantë titani që nuk ngjit i bën ato jashtëzakonisht rezistente dhe doreza e rehatshme prej çeliku inox qëndron fort në dorë, duke garantuar punë të sigurt.
26	Tepsi e thell e rrumbullaket 36 cm		Tepia per tave ushqimore është bërë prej çeliku i cili siguron një shpërndarje uniforme të nxehtësisë në tigan për një efekt gatimi më të mirë. Veshje jo ngjitesë siguron heqjen e lehtë të ushqimit, si dhe pastrim të lehtë të enës pas përdorimit.Dimesionet: pesha 0.60 Kg; gjatesia 36.00 cm; lartesi 7.00cm; gjeresi:36.00 cm; kapacitet 7.5 litra; trashesi 0.50 mm; diameter: 36.00 cm
27	Tepsi Cingu, Univerzale, 36CM		Tepsi univerzale , materiali: cingu; rezistente ndaj ngjitjes dhe djegjes se ushqimit
28	Tepsi alumini katrore me diameter 35cm x 45cm		Tepsi materiali: alumini; rezistente ndaj ngjitjes dhe djegjes se ushqimit me diameter 35cmx45 cm
29	Tepsi alumini e rrumbullaketme diameter 44 cm		Tepsi materiali: alumini; rezistente ndaj ngjitjes dhe djegjes se ushqimit me diameter 34 cm; produkti duhet te jet si ne foto

30	Pirun inox 18/10		Pirun te mdhenje ushqimi , materiali Çelik-inox; gjatesi 185 mm; peshe 25g; trashesi 1.2mm; rezistente ndaj ndryshkut;Fortësi e lartë, pa plumb;rezistuese ndaj nxehtesise;i lehtë për t'u pastruar, i përshtatshëm në larje enësh dhe i ripërdorshëm. produkti duhet te jet si ne foto
31	Luge gjelle inox 18/10,		Luge e madhe gjelleje, materiali: Çelik inox; gjatesi 216mm; peshe 100gram; trashesi 2.5mm;rezistente ndaj ndryshkut;Fortësi e lartë, pa plumb;rezistuese ndaj nxehtesise; i lehtë për t'u pastruar, i përshtatshëm në larje enësh dhe i ripërdorshëm; produkti duhet te jet si ne foto
32	Goruzhde (Kupat e supës për gatimin e kuzhinës)		Goruzhdei punuar nga materiali inox; me gjatesi: 280mm; peshe:121 gram; gjeresi: 83mm;;rezistente ndaj ndryshkut;Fortësi e lartë, pa plumb;rezistuese ndaj nxehtesise;i lehtë për t'u pastruar, i përshtatshëm në larje enësh dhe i ripërdorshëm; produkti duhet te jet si ne foto
33	Set I thikave te kuzhines; 18 pjesesh		Seti duhet te jen te punuara nga materiali inox; Tehet e qëndrueshme prej çeliku inox; Dorezat e dizajnuara në mënyrë ergonomike janë të dizajnuara për një kapje të rehatshme; thikat janë të balancuara në mënyrë të përkryer për saktësi gjatë prerjes; Seti permban: seti permban thika te formave te ndryshme per sherbime te ndryshme ; gershaje; qeruese i levoreve; prerës i i brumit; dhe mprehes i thikave. Seti (Artikujte) duhet te jene Si ne foto
34	Set melmesash; 4/1		Set melmesash komplet 4/1 te dimeioneve te njejta per perdorimin- konservimin e melmesave te ndryshme
35	Enë inox (tas me vegëz) 350 ml me dorezë		Tas sherbimi per pije te femijeve; materiali inox; specifikimet : kapacitet: 350ml; lartesia: 93mm; diameter: 77mm; forme e rumbullaket, rezituese ndaj nxehtesise

36	Enë inox (tas me vegëz) 0.28 L me dorezë		Tas sherbimi per pije te femijeve; materiali inox; specifikimet : kapacitet: forme e rumbullaket, rezituese ndaj nxehtesise
37	Luge inox te vogela per sherbim		Luge e vogel, materiali: Çelik inox;rezistente ndaj ndryshkut;Fortësi e lartë, pa plumb;rezituese ndaj nxehtesise;i lehtë për t'u pastruar, i përshtatshëm në larje enësh dhe i ripërdorshëm;
38	Tigan për pallaqinka		Tigani për përgaditjen e pallaqinkave duhet te jete i cilësisë së lartë, Baza mbrojtëse e tij e bën rezistent ndaj ngjitjes së pallaqinkave, por edhe gërryerjes së tiganit. Dimesioni 22 cm; ngjre e zeze ose ekuivalent dhe e punuar ng amateriali gure ose ekuivalent
39	Tabak per shervim 1/2		Seti I tabakeve per sherbim eshte dy pjesesh me dimensione :39x30x3cm dhe 34x26x3 cm qe Sigurojn qëndrueshmëri ne perdorim, jane te punuar nda druri
40	Tabak sherbimi plastike		Tabak sherbimi nga plastika me dimesione 36 cm x26 cm
41	Pjate gjelle e thell çelik - inox 18/10		Pjate per gjelle e thelle inox, rezistuese ndaj nxehtesise, e lehte per tu perdorur dhe mirembajtur dimensiononi Ø 17 cm
42	Pjate per sallate, e rrafshet , materiali inox 18/10		Pjate per sallate e rrafshet, e punuar nga materiali inox, rezistuese ndaj nxehtesise, e lehte per tu perdorur dhe mirembajtur dimensiononi Ø 17 cm
43	Tengjere e vogel per gjell 5L - inox		Tengjere inox; d24 cm;pesha 5 L;rezistuese ndaj nxehtesise, e lehte per tu perdorur dhe mirembajtur.
44	Tengjere e mesme per gjell 10L - inox		Tengjere inox; pesha 10 L;rezistuese ndaj nxehtesise, e lehte per tu perdorur dhe mirembajtur.

45	Thika te vogela per peme		Thika inox; te pershtashme per sherbimin e te gjitha funksionet;6/1
46	Kulluese enesh plastike per kuzhine		Kulluese enesh,Material plastike;Me hapesire te mjaftueshme ne tharjen e pjatave, gotave, tasave, luge, pirunj e thika etj ;Me ene plastike poshte per mbajtjen e ujit;Dimensionet e Produkteve: 41x49x10
47	Pllake prerese plastike e bardhe		Perbehen nga plastika me cilesi te larte;Siperfaqja e pllakave eshte e qendrueshme edhe e forte;Pastrohen lehtesisht me uje te rrjedhshem;e qendrueshme edhe e forte duke ju siguruar qe nuk thyhet lehte.
48	Pllake prerese druri		e punuar nga druri;Siperfaqja e pllakes prerese eshte e qendrueshme edhe e forte;Pastrohen lehtesisht me uje te rrjedhshem;e qendrueshme edhe e forte duke ju siguruar qe nuk thyhet lehte.dimensione 30cm x 45cm x2 cm
49	Kullesë profesionale për kuzhinë		Kullesë profesionale për kuzhinë Materiali: Çelik inox (Stainless Steel) Cilësi ushqimore Inox 304 (anti-ndryshk, i sigurt për ushqim); Madhësia: Diametri: 50 cm; Thellësia: minimum 20–25 cm Karakteristikat:Me vrima të vogla të dendura për kullim efikas Me 2 doreza anësore të forta (të salduara mirë); Me bazë mbështetëse (stand) për stabilitet Rezistente ndaj temperaturave të larta; E përshtatshme për përdorim intensiv (horeca / industrial); Përdorimi:Për kullimin e makaronave, orizit, perimeve dhe ushqimeve të tjera në sasi të mëdha Kërkesa shtesë (shumë e rëndësishme): Produkti të jetë heavy-duty (i përforcuar) Të mos jetë material i hollë që lakohet lehtë; Të jetë për përdorim profesional (jo shtëpiak)

50	Kullesa makarona/pasta3/1		Kullesa makarona/pasta 3/1 set; me 3 madhësi (23, 25, 27 cm); Dizajni i saj i thjeshtë dhe funksional lejon kullimin e shpejtë dhe efikas të makaronave, perimeve dhe ushqimeve të tjera të ziera. Rezistente ndaj nxehtësisë së ujit të zier, duke siguruar që kullesa të jetë e sigurt për përdorim Material inox qe nuk ndryshket dhe zgjat shumë Me doreza te forta dhe qe nuk nxehen gjatë përdorimit; Futet njëra brenda tjetrës; Baza (këmbë poshtë) shumë e rëndësishme që të mos prekë lavamanin
51	Tavolina plastke 64×64×48 cm		Tavolina plastke 64×64×48 cm; Material: polipropilen / plastikë e trashë,e fortë; material: antialergjik dhe i sigurt për fëmijë; Forma: dretëkëndore; Stabilitet shumë i lartë; këmbë me baza kundër rrëshqitjes dhe ngjyra te ndryshme si ne foto
52	Tharëse duarsh me sensor ngjyrë e bardhë, antibakteriale.		Filtri: Filtër antibakterial; Finitura: Mat Fuqia: 225 - 1000 Ë; Gjerësia: 18 cm Lartësia: 28 cm; Tipi: Tharëse duarsh Materiali: ABS; Montimi: Montim në murë Ndezja: Me sensor; Ngjyra: E bardhë Nivele shpejtësie: 300 km/hp; Opsion shtesë: Kursim energjie elektrike, Reze UV-C dizinfektante; Temperatura max: 45°C; Thellësia: 9.7 cm; zhurmë ≤ 65–70 dB
53	Grirëse e perimeve		Kapacitet qerre: 4 litra; Energjia: Elektrik, 220V / 50Hz (ose version 110V); Fuqi motorri: 300–500 Ë; Lloji i prerjes: Thika të mprehta, rrotulluese për grirje të shpejtë Material: Plastike dhe çelik inox për pjesët që vinë në kontakt me perimet; Siguria: Buton emergjence dhe mbrojtje për dorën

2

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë IEA ne Komunën e Lipjanit

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **21,730.45 €**; [njëzet e një mijë e shtatëdhjetë e tre euro e katërdhjetë e pesë cent] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	AGRON DEVA
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	MENAXHER
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.06.2026	Data:	29.06.2026
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 613-26-3165-1-2-1/C1209

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk

nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të sigurojë, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruar plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsye autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të njoftoj vendimin e tij të aprovimit i përmendur në Nenin 11.2 brenda afateve të përmendura në kontratë programi i tillë i realizimit duhet të konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Në qoftë se nuk ka afat të caktuar, ato do të konsiderohen të aprovuara 30 ditë pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim të ai.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualët e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të jenë në detaje të tilla që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualët dhe vizatimet do të jenë në gjuhën e kontratës dhe në formë dhe numrat të tilla të deklaruar në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manualët dhe vizatime të tilla janë furnizuar Autoritetit Kontraktues.

Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve

nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbledhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

